



*Rregjistroni fëmijët tuaj menjëherë edhe nëse viti shkollor ka filluar dhe kujtohuni që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë edhe n.q.se nuk janë në rregull me normat e qëndrimit (OKB, Marrëveshja Internazionale mbi të Drejtat e Fëmijërisë, Neni. 28 e DPR 394/99).*

## Sistemi Shkollor

Në Itali çdo nxënës duhet të frekuentojë shkollën o formimin profesional deri në 18 vjeç. Kjo e drejtë / detyrë i përket gjithë nxënësve të huaj, me dokumenta të rregullta o pa dokumenta, me ose pa leje qëndrimi:

E drejta-detyra e mësimi dhe formimit përfshin 12 vjet (duke filluar nga mosha 6 vjeç) brenda sistemit shkollor o marrjen e një kualifikimi brenda sistemit të mësimi dhe formimit profesional brenda moshës 18° vjeç. Megjithatë, ngelet detyrimi i mësimi për 10 vjet (nga 6 deri në moshën 16 vjeç).





## Sistemi edukativ italian organizohet si më poshtëe:

1. Kopështi (mosha: nga 3 deri në 6 ), nuk është i detyrueshëm, që zgjat 3 vjet; në rast se nuk ka vend shkruheni në një listë (Lista e Pritjes) e cila nuk garanton rregjistrimin.
2. Cikli i parë i mësimi, i ndarë në:
  - ✓ **Shkolla fillore** (mosha: nga 6 deri në moshën 11 vjeç), e cila zgjat 5 vjet
  - ✓ **Shkolla dytësore e gradës së parë** (mosha: nga 11 deri në 14 vjeç), e cila zgjat 3 vjet.
3. Cikli i dytë i mësimi, i ndarë në:
  - ✓ **Shkolla dytësore e gradës së dytë** (mosha: nga 14 deri në moshën 19 vjeç), e cila zgjat 5 vjet. I përkasin këtij grupi licetë, institutet teknike, institutet profesionale dhe institutet e arteve (institutet profesionale dhe institutet e arteve ofrojnë edhe kurse trevjeçare);
  - ✓ **Formimi profesional** fillestar është në kompetencat e krahinës, zgjat 3 vjet, i drejtohet të rinjve që kanë përfunduar ciklin e parë të mësimi;
4. Mësimi dhe formimi pas-dytësore jo i lartë, që zhvillohet në rrethin e sistemit të Mësimi dhe Formimi teknik (IFTS) dhe që ofron IFTS dhe kurse të Instituteve Teknike (ITS);
5. Mësimi i shkollës së lartë, përbëhet nga mësimi universitar dhe jo-universitar. Sistemi i mësimi të lartë ndahet në institute shtetërore e jo-shtetërore.